



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.

DREJTORIA E PROKURIMIT DHE ANKANDIT

Nr. _____ Prot.

Patos më, ____ .10.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Marrje automjete me qira”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT Kodi CPV: Marrje me qira të mjeteve të transportit 60170000-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 96,992,000 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, ose 916,662 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) Euro pa tvsh me kursin e kembimit te dates 26.10.2023

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Bazuar në nenin 39 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” parashtrijmë arsyet kryesore për vendimin e mosndarjen në lote për këtë procedurë.

Kompania Albpetrol sh.a ka në administrim tre qendra prodhimi të naftës, QPN Kuçovë, QPN Fier dhe QPN Gorisht të cilat aktivitetin e tyre e kanë në terren dhe rrugë të vështira (të gjithë kategoritë e rrugëve) arsye kjo pse shumica e automjeteve që do të merren me qira janë tipi Pick Up (Dopio Kabine).

Automjetet e kërkuara për tu marrë me qira janë të gjitha automjete për përdorim në terrene të vështira jashtë rrugë (fuoristrada) me qëllim përmbushjen e nevojave të Albpetrol sha në aktivitetin e përditshëm të transportit të materialeve, veglave të punës dhe personelit inxhinier-teknik apo cdo aktivitet tjetër që mund të kërkohet në vendburimet e naftës në administrim të Albpetrol sha. Për këtë arsye procedura është menduar si një e tërë pa e ndarë në lote pasi automjetet e kërkura janë të gjitha për një qëllim dhe janë të një kategorie. Gjithashtu ndarja në lote mund të sillte vështirësi në implementimin e kontratës dhe mospajtimin në të njëjtën kohë i të gjitha automjeteve do të sillte kosto të shtuara dhe vështirësi në aktivitetin kryesor të kompanisë që është nxjerrja trajtimi dhe shitja e naftës brut.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 2 e LPP, si dhe nenin 41 pika 4 gërma ”a” dhe ”b”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Këto kritere shërbejnë për të provuar se ofertuesit janë të licencuar në lidhje me këtë shërbim si dhe kanë kapacitetet profesionale për kryerjen e shërbimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vertetim nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore të realizuar në tre vitet e fundit 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se vlera e fondit limit objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Kopje të certifikuar të bilancit për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si deshmi për përvojën e mëparshme kërkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OSE

Ne rastin e përvijes se meparshme te realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvijën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 ose e përditësuar mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtyre kërkesave AK kërkohet të sigurohet që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin dhe janë të certifikuar në përputhje me kërkesat e menaxhimit cilësisë dhe ky kriter i vendosur është në përputhje të plotë me objektin e prokurimit.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për automjetet që ofron. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që verteton lidhjen e distributorit të autorizuar me firmën prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe se mallrat e ofruara janë konform të gjitha standardeve dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.4. Kataloge teknike/skede teknike, nga firma prodhuese për automjetet që do të ofrohen. Katalogu/skeda teknike të përmbajë karakteristikat teknike të automjeteve me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse automjetet plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në katalogun/et/skedat e paraqitur të shënohen në mënyrë të dukshme lloji i automjeteve, së bashku me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. (Pjesët specifike të katalogut/skedës teknike, ku jepen karakteristikat e mallit që prokurohet nëq nuk janë në gjuhën shqipe të përktheshme në gjuhën shqipe dhe të noterizohen).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se malli i ofruar është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.5. Operatori ekonomik të ketë servis të autorizuar për shërbimet që mund ti kryhen automjeteve.

Per kete ofertuesi te paraqese:

- Licence per autoriparimin e mjeteve rrugore leshuar nga QKB.
- Ne rastin kur nuk ka vete servis automjeteve te paraqese kontrate qiraje/bashkepunimi te lidhur para noterit me nje servis, qe te perfshije periudhen e kontratës objekt prokurimi për mjetet qe ofertothen, shoqeruar me licencen per autoriparimin e mjeteve rrugore ne emer te servisit leshuar nga QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe shërben për të garantuar AK se ofertuesi i ka kapacitetet teknike për kryerjen e këtij shërbimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e prokurimit: